

CHRISTOS HATZIPAPAS  
**NGJYRA E ZYMBYLIT TË KALTËR**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



CHRISTOS HATZIPAPAS

NGJYRA E ZYMBYLIT  
TË KALTËR

*roman*

*Botimi i dytë i ripunuar*

Përktheu nga origjinali greqisht  
Kristo Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Χρίστος Χατζήπαπας (Kristos Haxipapas)  
Titulli në origjinal: ΤΟ ΧΡΩΜΑ ΤΟΥ ΓΑΛΑΖΙΟΥ ΥΑΚΙΝΘΟΥ  
Botoi në greqisht: ΓΚΟΒΟΣΤΗΣ

Për botimin e këtij libri në shqip ndihmoi:  
Deputy Ministry of Culture - Department of Modern  
and Contemporary Culture

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Albina Pulla  
Korrektore letrare: Edona Marku  
Përkujdesja grafike: Edona Marku  
Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 9789928376671

© 2019 Χρίστος Χατζήπαπας  
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)  
<https://toena.al/>

*Kushtuar Filipit, Vasilisë, Markos dhe Kristos.  
Të mbahen mend, edhe kur kujtesa të shuhet.*



## Hyrje

BOTIMI I DYTË i romanit “Ngjyra e zymbylit të kaltër” nga Botimet GOVOSTI, tridhjetë vjet pas botimit të parë nga Botimet KASTANJOTI, ishte e imponuar për shumë arsye. Historia me të gjithë komponentët e saj: koha që kalon pa kokëçarje apo në mënyrë torturuese, dashuria që transformohet sipas kahut të sjelljes së njerëzve, shpresat e humbura që lanë pas gjurmë të pashlyeshme, gjuha që zbut shprehjet bombastike, memoria që kërkon me këmbëngulje pjesën e saj në zhvillimin e ngjarjeve, letërsia si ilaç shërues i Historisë dhe konkurrues i denjë i saj, të rinjtë që po vijnë, dhe ata që ikin duke ndryshuar skenarin e peizazhit njerëzor, duan... t’i rrëfejnë diçka. Madje edhe pjesa e pasme e kopertinës së botimit të parë, që ka mbaruar në treg këtu e shumë vjet më parë, proteston për papajtueshmërinë me peizazhin e sotëm. Po e paraqes: *Që në pamje të parë, dallohet një natyralizëm që përshkon ngjarjet e zhvilluara. Por kjo, veçse, nuk është aspak verdikti i romanit. Mbrapa fakteve të pakundërshtueshme ka ngritur folenë e vet disfata shpirtërore apo euforia moskokëçarëse, që do të duhet, ndërkohë, edhe ajo të dënohet... Personazhet tona, me Petron në radhë të parë, të rinj, pothuajse ende adoleshentë, thua se e kanë filluar jetën e tyre në mënyrë amatore. Improvizojnë. Luajnë me të me shfaqjet e saj të veçanta: me dashurinë, historinë, letërsinë dhe gjuhën, me punën, trupin, ideologjinë, madje edhe me vdekjen. Ashtu si vepron në mënyrë identike dhe mikja e tyre më e madhe: Qiproja adoleshente dhe e papërvojë...*

Ky tekst nuk mund të përsëritej sot në pjesën e pasme të kopertinës së botimit të ri. Qiproja nuk është më një adoleshente, por një plakë e përdhunuar që e ka humbur busullën. Po, ajo improvizon, thua se po përgatit një gjëmë tjetër... As heronjtë nuk janë më adoleshentë. Sot vëllai më i vogël është gjashtëdhjetë e ca vjeç, *që për herë të parë thithi tym mortaje në vend të cigares*, siç kam shkruar në njërën prej poezive të mia, por që mbijetoi i gjymtuar nga lufta e tradhtuar dhe jeton sot, vitet më të vështira të jetës së tij, janë ushtarët të cilëve nuk u kishin dërsirë mustaqet, që u vranë krah tij në fushën e betejës, janë miqtë e tij, fati i të cilëve nuk dihet. Është marrëzia revoltuese e tradhtisë, madje edhe nga vetë oficerët e tyre. Por është edhe dashuria, që zbut disfatat, disfatat më të mëdha dhe mbijeton brenda gjallërisë së dhembshurisë. Kerinia adoleshente dhe e bukur, qyteti i dashurive të fshehta dhe i bukurisë së çuditshme, me pesë a gjashtë mijë dashnorë atëherë, vendas dhe të huaj, mezi po mbijeton me ato gjeste vulgare të dyzet mijë përdhunesve që erdhën nga Anadulli, kazinotë e trupit të nxjerrë në treg, por edhe me nostalgjikët e saj autentikë, me ata që kanë mbetur tashmë, që e vështrojnë nga larg *dhe mendja e tyre pushon së funksionuari...*

Një tjetër arsye janë miqtë, ata më të rinjtë, si ata që zbukurojnë kopertinën e pasme. Të parët, lexues në moshë të re atëherë, dhe të tjerët, në moshë më të pjekur, që arritën në përfundim dhe bindën dhe të tjerë, që ky libër duhet të lexohet prej më të rinjve dhe të rilexohet, në kuadrin e arritjes së pjekurisë së njerëzve si të ngjarjeve që kanë rrjedhur... I falënderoj të gjithë, ashtu sikundër, sigurisht, dhe Botimet GOVOSTI, që kontribuuan për këtë vepër.



## I

### *Njohja e parë. Spitali*

LARG NË HORIZONT dritarja ndahej më dysh nga maja e një selvie. Në pjesën e poshtme mbështeteshin mbi parvaz majat e eukalipteve degëndur. Në gjendjen që ndodhej, i shtrirë vazhdimisht në krevat, këto ishin shenja se ndodhej rreth treqind metra larg shtratit tashmë të tharë të lumit Pedieos. Dhe përtej këtyre, një kaltërsi e pafund, Zoti e bëftë të kaltër, ashtu siç ishte i mbështjellë me një shtresë të rrumbullakët pluhuri nga era e fortë dhe përvëluese e asaj vere të thatë dhe zhgënjyese. Por kjo pamje vetmitare kishte ditë që nuk i tërhiqte më vëmendjen. E treti brenda vetes, ashtu si ndodhi me një grua që dikur ia kishte marrë mendjen, por që prej kohësh nuk i bënte më përshtypje, ngaqë kishte zbuluar të gjitha misteret e saj.

Tani e torturonte diçka tjetër. Duke u dridhur futi dorën nën çarçaf, thua se edhe vetë ai po rrëshqiste fshehurazi që të hetonte personalisht mbi pritshmërinë e tij. Ishte hera e pestë, e kupton, që përpiquej ta ringjallte, por asgjë! Ishte e kotë. Sado që u përpoq të rreshtonte rreth tij, me një shpresë mosbindjeje, kurtizane epshndjellëse duke kërcyer në gjysmerrësirë, ai preferonte takime me virgjëresha të turpshme, në shtratin e thatë e hijerëndë të Pedieos, si dhe lloj-lloj sajesh të tjera...

Pothuajse një muaj përpara, kur i hoqën një pjesë të allçisë dhe fashat që kishte në kokë, atij iu zbulua zbehtë para syve rreshti i majave të eukalipteve dhe besoi se një pjesë e jetës i ishte përtërirë nga ai udhëtim i largët

dhe i çmendur. Udhëtim që zgjati një moment, por dhe pabesueshmërisht në përjetësi, ndoshta deri në prag të vdekjes. Mendja e tij qëndroi për ditë të tëra pa dyshuar në asgjë, derisa shijoi funksionet e para, u familjarizua me to, iu mërzitën dhe kërkoi që t'i ktheheshin edhe funksione të tjera... Për shembull ajo, e qenësishmja.

Tjetri në krah të tij gërhiste, ndërkaq, herë pas here në fytyrë i mbinin toptha të vegjël djerse, si paralajmërim të një shiu të rrëmbyeshëm veror.

- Shpëtove paq miku im, - iu duk sikur dëgjoi një zë të ëmbël në atë tymnajë, teksa i pëshpëriste me simpatinë e mirëbërësit për të dënuarin, në momentin që ishte gjysmë i zgjuar pas një letargjie të thellë.

Zë i njohur, nëse edhe aftësia e tij për të dalluar tingujt nuk ishte e sakatuar si kaq shqisa të tjera. Sytë e tij, të strukur pas allçisë, e kishin të pamundur ta ndihmonin që ta dallonte kush ishte. Vrau mendjen, e shtrydhi që të mund të kujtonte, derisa i filloi dhimbja e kokës. Kjo përpjekje, godiste për shumë kohë si një top i fryrë muret e zhveshura të mendjes së tij, derisa infermierja e pickoi në krah.

Përpara se gjumi ta gjunjëzonte sërish, tha diçka të pakuptueshme, si një frazë me shkrim të dalë boje.

- Tripiti...

Gjithmonë...

Mbetet...

### *Njohja e parë. Kerinia*

Tripiti ishte në Kerinia. Një shteg i ngushtë dhe i gjatë që bashkonte rrugicat gjarpëruese dhe ato si labirint me portin dhe pafundësinë.

Në qytet u vendos para dy vjetësh, duke iu bindur transferimit që i kishte rënë si tullë në kokë. Ngaqë nuk e priste, por edhe se nuk kishte ndër mend t'i kalonte vitet e tij më të furishme në këtë qytezë, të fshehur nga Zoti dhe nga dielli. Për më tepër, e vetmja gjë e përbashkët mes tyre, përveç hartës gjeografike, ishin disa kujtime të vakëta nga një ekskursion që kishin bërë dikur, kur ishte në gjimnaz, të cilat vështirë se mund të luanin ndonjë rol për një kompromis në të ardhmen. Ishin kujtime që e mbushnin me hidhërim. Mbante mend se një pjesë e madhe e udhëtimit ishte bërë nën hijen e malit të gjithëpushtetshëm Pentadhaktillo. Udhëtim, i cili zgjatej si një monopati milingonash nën pemët e limonit të Lapithës. Diku aty udhëtimi u ndërpre për të vizituar Qendrën e Riedukimit për minorenë. Ide gjeniale e Triplosit, mësuesit të lëndës fetare, i cili synonte të mbyllte aty me çdo kusht një nxënës të klasës së tretë, i cili urinonte herë pas here në gjumë. Por më kot, zotëri! Nëse ishte kështu, që çdokush mund të mbyllte aty cilindo që dëshironte, atëherë, ne shurranjosët, do të të mbyllnim brenda ty - fajtorin kryesor që na çmend netëve me ato alarmet e tua. Por për fat, situatës i dha zgjidhje një njeri i matur dhe zemërflori, mësuesi i letërsisë. Ai ishte me origjinë nga Azia e Vogël dhe kishte vuajtur shumë në jetë. Pas kësaj, ekskursionin vazhdoi për t'u ndërprerë përsëri befasi në port, ku i lëshuan për të blerë nga një akulllore dhe për të bërë shëtitje duke e lëpirë atë. Por para se të gjenin një vend të përshtatshëm për një cigare, filloi papritur shiu që i detyroi të strukeshin sa hap e mbyll sytë nëpër autobusë.

Ajo që e qetësonte disi tani pas transferimit, ishte Njëshi i Engjëjve, siç e thërrisnin njërin prej tre bashkënxënësve zemërmirë, të cilët e kishin mirë me Triplosin. Sigurisht që kishte kaluar kohë e gjatë qëkur të tjerët ua kishin

falur thyerjen disiplinore, sepse edhe vetë ajo fundërrinë trashaluke i kishte trajtuar si armiq të nesërmen e një rrëfimi të singertë. (Për këtë lloj qasjeje hyjnore, e cila, duke u braktisur, shndërrohet në një shëmti në duart e njerëzve, do të flasim në kapitullin pasardhës.)

Njëshi i Engjëjve, pra, e kishte origjinën nga Lapitho, tetë milje në perëndim të Kerinias, do ta kishte koleg dhe një Zot e dinte... se çfarë tjetër, këtej e tutje.

Derisa t'i kalonin nëpër mend të gjitha këto kujtime, autobusi i kompanisë “Lampusa” ndaloi përpara godinës së bashkisë. Valixhen e kishte të lehtë. Me kalimin e kohës njeriu fiton zakonin e vendosjes në valixhe të gjërave të panevojshme. Të ndiejë siguri kur i ngarkon në nisje dhe i shkarkon në mbërritje. Për momentin, ai ndihej i sigurt me ndihmën e një këmishe prej akriliku hedhur supeve, që e bënte, me të vërtetë, të mbytej në djersë. Një bluzë sintetike me një lule ngjyrë jeshile të zbehtë në gjoks, dy palë pantallona, një veshur, të tjerat në valixhe. Të brendshmet numëroheshin me gishtat e njërës dorë, ndërsa çorapet të arnuara te thembrat. Tre a katër libra, një radio dore me bateri të blerë në treg të zi dhe një fletore me krijimtari artistike, poezi të zgjedhura. Ato që i mbijetuan një përzgjedhjeje të dalldisur, kur një mëngjes e konsideroi si detyrë sublime të tij, të ndante artin nga gjërat e pavlera, duke i lënë në mëshirë të erës që po frynte fletët me krijimtari që e gjykonte të panevojshme. Fjalët që simbolizonin Greqinë, dashurinë, padrejtësinë, përsëriteshin shumë shpesh. Ishte edhe ajo fjala “përse” që përsëritej shpesh, thua se ishte ligjësi, dhe përplasej mbi të në errësirën e natës. Edhe tani, po ato fjalë, sado të gabuara që mund të ishin, kishin po atë objektiv. Mbante me vete dhe një letër nga nëna e tij, e cila i lutej

të ndihmonte motrën për t'u martuar, tani që ai vetë kishte zënë një vend të mirë... Sa të rënda këto bagazhe!

Të gjithë e konsideronin të bukur. Sylfide e quajti një poet, i çmendur me siguri. Ndërsa atij vetë i dukej e ftohtë dhe e paarritshme, madje edhe ia kishte frikën. Një grumbull shtëpish të ngulura në bregun e detit dhe rrëzë malit, dukej sikur ai qytet planifikonte në mënyrë metodike vdekjen e tij, si do të thoshte dikush duke e parë në profil. Nga një pakujdesi, pak sikur të anonte mali Pentadhaktillo do ta bënte petë, apo sikur të zemërohej maja e tij më e lartë, Rijena e egër, Kerinia do ta gjente veten të fundosur. Kur të egërsohej deti do ta fshinte nga bregu i tij dhe nga shpati i Pentadhaktillosit të krekosur. Dhe në mëngjes do të mbeteshin themelet e saj të shkatërruara, të rrënuara, si prerje të një plani satanik arkitektonik.

- E bukur është, nuk mund ta mohosh, - e ndërpreu nga meditimet bashkënxënësi i tij, që ishte treguar i gatshëm ta shëtiste nëpër qytet.

- Dhoma është problemi. Si thua, do të gjejmë? - foli paksa i menduar Petroja, i cili do të preferonte që heshtja të zgjaste edhe pak akoma.

- Mos u nxito, në këtë qytet ai që kërkon gjen, - ishte përgjigjja që mori.

Kudo vajza thatanike me vetulla si shigjetë. Nëse merr frymë thellë, rryma e ajrit do të t'i hedhë në prehër. Sy të zinj, amalgamë dëlirësie dhe epshi, ballë i lartë dhe i lëmuar, buzë të holla por mishtore. Diçka i kujton. Memoria e tij këmbëngul... Po, kjo është, afishet turistike. Ku bluza e shkurtër, e ngritur paksa gabimisht, të lejon të përfytyrosh gjoksin e vogël, por të fortë dhe aureolën ngjyrë mavi përreth kraterit magjik.

Përfundimisht u vendos te shtëpia e Alisavës. Varianti qipriot i emrit Elisaveta. Një e moshuar që lëshonte dhoma me qira në rrugën “Pavarësia”. Jaseminët kacavirreshin nëpër ballkone, begonja dhe lulebore nëpër shkallë, ndërsa një tjetër bimë kacavjerrëse kapej te paneli diellor dhe ngjante si një engjëll mbi tokë.

E ndoqën pas me durim pronaren e moshuar, që, më në fund, hapi derën e dhomës së fundit në katin e sipërm. Nuk ishte ndonjë gjë kush e di se çfarë, por s’ishte problem, mendonte Petroja, ishte një qoshe të paktën ku do të mund të linte valixhen, librat, që së shpejti synonte t’i shumëfishonte, kishte dritare me grila dhe brenda errësohej, për të pasur mundësi të dëgjonte në radion e dorës muzikë dhome gjatë orëve të vetmisë. Por më tepër i pëlqeu, sepse për momentin besoi që në këtë ambient disi të mënjanuar, larg vendeve dhe njerëzve që njihje deri tani, në një qytet gati të paafreshëm, do të gjente një qetësi si në ëndrra, që do t’i jepte mundësi të punonte dhe latonte vargjet e poezive të tij, por dhe, në fund të fundit, të bënte çfarë të donte me veten e tij, pa i dhënë llogari askujt...

Njëri prej dy shtretërve ishte bosh, domethënë nuk kishte çarçafë, nga ata të hirtët.

- Do t’i zboj, të gjithë, - belbëzoi plaka duke zgurdulluar sytë e saj të kaltër. Shtrembërimi i fytyrës tregonte më së miri neverinë për pisllekun në dhomë. I mbështolli mbulesat ngjyrë gri me një rën dorë, sepse tjetrën e mbante të mbledhur, mbase nga ndonjë sëmundje, dhe i flaku në korridor. Duke dalë, mori zvarrë me këmbë dy palë mbathje me një vijë ngjyrë kafe te llastiku. Ia futi me shkelm dhe një shisheje me parfum.

Dolën për të blerë çarçafë. I pamësuar me gjëra të tilla, miku i tij e çoi në një dyqan artikujsh turistikë. Çarçafë prej mëndafshi me thekë. Qëndisma të punuara me dorë nga artizanet e Lefkarës - shkruante në vitrinë - dhe me siguri që do të kishte edhe riprodhime figurash nga mozaikët që ishin zbuluar në Pafon e Poshtme dhe që paraqisnin prodhues të lashtë verërash. E kapi frika. Jo, u mat të thoshte ai në hyrje të dyqanit, po ku ta dëgjonte Andrea, që u fut menjëherë e madje kishte filluar të bënte pyetje për ato që u interesonin.

Bleu diçka të thjeshtë, për vdekatarë, se nuk i dilnin paratë për diçka tjetër, por në fund u detyrua t'i merrte hua shokut të vet. I tha me gjysmë zëri se do t'ia kthente mbrapsht në kthim, por çfarë t'i kthente, si, kur përveç disa të hollave, nuk i kishte mbetur gjë tjetër.

Sa budalla që jam, mendoj. Një mijë herë i kam thënë vetes të mos vihem në situata të tilla, por kur vjen puna, prapë gjëra të pamenduara bëj. Prej kohësh e kishte vënë re që nëse gjendej papritur pa një grosh në xhep, i prishej humori, qielli nxihej dhe i binte si një gur i rëndë mbi kokë. I vinte të hidhte ato që kishte blerë në një përrua aty pranë, i cili gjatë verës dhe vapës së padurueshme shteronte në sipërfaqe dhe uji rridhte nën tokë. Ia çante hundën era e suflaqeve që piqeshin, por nuk ndihej. Kishte pa ngrënë që në mëngjes.

Përsëri shëtitje, guida nëpër labirinte, rrugë me kalldrëm që të çonin direkt në oborre shtëpish gjithë diell, ku kishte të nderur çarçafë prej leshi dhe kadifeje, si dhe qenushë që jetonin si ilegalë rrëzë mureve të lyera me gëlqere. Vajza të reja, ulur këmbëkryq në mindere të vendosura nëpër oborre, qëndisnin në gjergjefët e mëdhenj si diej, lule ekzotike dhe brenda tyre disa stamenë të kuqërremtë, ndjellës për burrat... për dikë të sapoardhur, i cili kaloi me nge në Tripiti, ditën

e parë të ardhjes në qytet, rob potencial i prehërave që nuk kishin njohur dashuri. Në shiun pasardhës, vetullat e këtyre vashave do të ngjanin me ylbere.

Më lart dhe paksa larg, shoku i tregoi Mitropolinë. Kujtuan mitropolitin Qipriano dhe tregimet humoristike që qarkullonin në lidhje me vizitat e tij në Morfo. Dy duzinat e pëllumbave të vegjël që gëlltiste si gjarpër për drekë. Kujtuan pastaj Triplon, mësuesin e lëndëve fetare, që i merrte shpeshherë në kishë që të dëgjonin Shenjtin e “frymëzuar” duke predikuar “idealet e vërteta qipriote” - Bashkimin me Nënë Greqi. Fytyra e tij e dhjamur kullonte në djersë, dhe nëse nuk do t’i ofronin vazhdimisht ujë, do të dehidratohej, do të tkurrej, në fund do të mbetej një kokërr e zezë si mizë mishi mbi foltoren e predikimit.

- Pas gjithë këtyre, çfarë beson ti për Bashkimin? - e formuloi pyetjen në mënyrë të tillë që edhe përgjigja të ishte respektive. Përgjigje pozitive priste ish-nëntogeri i këmbësisë, në specialitetin e mitraljerëve, me Numër Amze Ushtarake 3739.

Andrea iu shmang përgjigjes edhe për faktin se ndërkohë filloi një shi i rrëmbyeshëm, por që zgjati vetëm disa minuta.

- Ja tek është dhe Tripiti, - i tha pasi shiu kishte pushuar, ndërkohë që pika të trasha, por të rralla vijonin të binin akoma mbi tastierën e pianos së detit, duke lëshuar tinguj melankolikë. Dielli e zgjati qëndrimin mbi horizont, për të pasur kohë që të mblidhte ngjyrat, muzikën dhe të gjitha instrumentet e magjisë së tij.

Porti i vogël dhe i mbyllur, shiu që filloi, i sollën në kujtesë ekskursionin para... një, kur ishte në gjimnaz, dy, kur ishte në ushtri, tre, kur punonte si punëtor i pakualifikuar... para katër vjetëve. Vetëm se kështjellën, apo Kastron, nuk



e mbante mend fare. Si mundi të rritej kaq brenda pak vjetëve?

Ajo ishte aty që në kohën e venecianëve, vetëm se ai nuk e kishte vënë re.

- Ekzistonte, - përsëriste me ngulm Andrea, dhe për pak sa nuk vuri bast se po, ekzistonte dhe përgjegjësia që nuk e kishte vënë re i takonte Petros. Dhe shtoi se një ditë, do të njiheshin më mirë me Kastron, dhe se ky takim do të ishte i frikshëm... Por Andrea nuk ishte profet, ishte thjesht një engjell.

Për dreq, pas pak kohe do t'i duhej të paguante diferencën e atyre çarçafëve që bleu. Në thellësi, dielli dukej si një top i kuq, si një top i qelqtë ngulur në det.

- Ai që kalon në Tripiti ditën e parë të ardhjes, hedh rrënjë këtu.

- Aha, unë nuk i besoj këto besëtytni, - tha me njëfarë droje Petroja, që nuk ishte i sigurt për ato që thoshte.

- Kështu është po të them, është e vërtetuar kjo. Gjysma e numrit të burrave në Kerinia janë vidanë. Vidan do të thotë pëllumb mashkull.

- Po nëse kthehem menjëherë mbrapsht?

- E po, atëherë...

Nuk u kthye. Pinë kafe në port dhe kur biseda u ndez, porositen uzo. Pas gllënjës së parë, Petroja i tha shkoqur Andreas se nuk kishte para për t'i kthyer borxhin për çarçafët, kështu që do t'i duhej të priste deri në fund të muajit.

- As mos e mendo, - iu përgjigj tjetri, pa menduar se çfarë do të hante miku i tij gjatë asaj një jave e gjysmë.

Në darkë fjeti me makthe dhe me erën e naftalinës. Stomaku iu trazua dhe së bashku me uzon, nga goja i

rrihnin copëza kafeje të pabluar dhe farërash të thata. U hodh një vrap deri te qoshja që shisnin suflaqe për të blerë një pite. Derisa t'ia bënin gati, ai rrëmonte dhe pastronte xhepin, ashtu si pastroi pak më parë stomakun, duke kërkuar atë gjysmë centi që i mungonte.

- Dëgjo, ndërrova pantallonat pak më parë dhe... As që iu desh ta mbaronte fjalinë. Shitësi e kishte mbështjellë ndërkohë piten dhe ia vuri në dorë. - Nesër, - tha. Pak më poshtë, një qen rrugësh ia rrëmbeu nga duart.

U zgjua për herë të dytë, ngaqë iu duk sikur kishte lagur çarçafët dhe po e çonin në Qendrën e Riedukimit.

- Tani jemi afër, nuk i shpëton dot këtë herë, - përsëriste duke qeshur me sarkazëm Triploja. Dhe duke hequr lidhësen e këpucëve, vazhdonte: - Eja, nuk shpëton dot, zog i vogël, do të ta lidhim... A nuk është kështu, Dhespot? - tha duke u përkulur si skllav para Mitropolitit.

- Por tani nuk jam më nxënësi yt, - bërtiti i revoltuar, gati për t'ia futur me grusht në gojë. Por menjëherë pastaj mendoi që të sillej më butë, sepse nuk i dihet, ndonjëherë mësuesit e lëndëve fetare mund të të vizitojnë edhe në gjumë... Edhe unë jam ithtar i idesë së bashkimit, përse më torturoni?

E qeshura diabolike i Trinisë së Shëndoshë të Shenjtë - Triplosit, Dhespotit dhe një gardiani të Riedukimit, i zi në fytyrë dhe me brirë - e tronditi nga themelet pensionin e Alisavës apo Elisavetës. Ha-ha-ha dhe pas tyre jehona që i bënte edhe më të forta.

I mbytur në djersë, u ngrit dhe vajti në tualetin ngjitur, u shpëla dhe futi gishtat në gojë. Nxori të gjitha ato që kishte ngrënë dhe ato që nuk kishte ngrënë gjatë njëzetekatërorëshit të fundit dhe u qetësua.

*Spitali. Fija e parë*

Kur u zgjua, me siguri që ai tjetri do të ishte në gjumë, sepse nuk dëgjohej asnjë zhurmë.

- Ej, mik! - i foli për t'u siguruar.

Nuk dëgjohej asgjë. Dhe një e keqe më tepër për të ishte se nuk mund të dallonte nëse ishte ditë apo natë. - Ej, mik! - i pëshpëriti përsëri. "S'ka mundësi, - mendoj me vete, - atë shprehjen 'ia hodhe paq, shpëtove' që dëgjoji, duhej t'ia kishte thënë dikush që ishte me të, po ku?"

Por ja, pas pak zërat po shtoheshin, ishin tingujt e ditës, aty ishte një vend ku grumbulloheshin shumë njerëz.

- Të gjithë nëpër dhomat tuaja. Po vijnë mjekët, - u dëgjua një zë gruaje.

- *Visitation*-i, - tha një zë tjetër, zë burri këtë herë, gjithë melankoli.

Fakti se ndodhej në spital apo në ndonjë klinikë të madhe, nuk kishte më vend për dyshime, megjithëse besonte se e keqja që e kishte gjetur, nuk duhej të ishte dhe kaq serioze. Por gjithsesi e kuptonte që kokën e kishte të fashuar, gjë normale, me atë copë metali që e zuri shkarazi dhe që për pak do t'i kishte shkukur vetullën. Pyeti veten se sa orë kishin kaluar vallë nga momenti kur pranë tyre shpërtheu ajo predhë mortaje.

- Ej, mik!

Tani e dëgjoji qartë zërin e njohur që vinte nga larg dhe vazhdimisht afrohej.

- A u zgjove? - u dëgjua përsëri ai zë, këtë radhë pothuajse te veshi i tij. - Mjekët thanë që nesër, ose pasnesër, do të të heqin fashot edhe nga fytyra. Do të mund... të shohësh mikun tënd të vjetër.

Këtë radhë, pa u sforcuar aspak, lokalizoi me saktësi se nga i vinte ai zë.

- Andrea! Edhe ti, këtu qenke? Gëzohej, a thua se e takoi në shkallët e universitetit, aty ku nuk ishte e thënë që të shkelte kurrë, megjithëse doli fitues në provimet e pranimit, këtu e tre vjet më parë. - Ku ishte, kur të thirra pak më përpara?

- Bëra një xhiro te dhomat këtu afër. U mërzita kaq ditë këtu brenda. Është këtu një grua zonjë e cila më ndihmon kur...

“Ç’thotë prapë ky”, mendoi i shqetësuar Petroja. “Ky, e marrtë dreqi, po na e paraqet situatën sikur jemi duke vdekur. Ditë... thotë. Pas pak do të thotë kemi muaj këtu”.

- A s’më thua? Andrea je...?

- Po pra, An...

- Andrea je, në rregull... Kolegu? Nga Kerinia, dua të them... “Po ky ore, kishte rënë që...” mendoi Petroja.

- Dora vetë! - u përgjigj, sikur po njiheshin përsëri nga fillimi, pas kaq vitesh.

- Seriozisht e ke, mik? U gëzova... “që të shoh përsëri”, - u mat të thoshte, por menjëherë e mblodhi veten. - Shiko çfarë thotë, gëzohet... Të gjithë e dinim se kishe humbur. Kur re dhe u mblodhëm rreth teje... Çfarë të të...

Nuk e përfundoi frazën, sepse në atë moment filloi të dyshojë se gjërat kishin ndryshuar shumë që nga ai moment, se mund të kishin kaluar shumë ditë...

- Ajo që patë nuk ishte gjë... Frikë ishte, gjendje shoku... U përmenda pothuajse menjëherë. Pastaj... - Ndoshta donte të thoshte se çfarë pa dhe çfarë... si i fundit që mbeti... - Nejse, mos u mërzit, Petro, - i tha. - E keqja më e madhe kaloi, - vazhdoi.

Por Petroja ishte zhytur në heshtje. Nuk e dëgjonte më shokun, bashkë me të cilin kishin kryer shërbimin ushtarak, dhe që i kishte rënë të fikët. Vetëm se ato fashat e bardha që i fshihnin sytë, nuk e lejonin Andrean të kuptonte nëse e kishte zënë gjumi me të vërtetë.

- Fli, “fasulexhi”, - vetëm kaq tha, duke dashur të afrohej që t’i përkëdhelte flokët, atë tufë flokësh që kishte mbirë në të çarën mes fashave dhe allçisë.

### *Fati i një të pjerdhure*

“Fasulexhinj” ishte nofka e tyre e përbashkët në Kerinia. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, ngaqë të gjithë në atë qytet të vogël kishin nga një epitete, apo nofkë si të thuash, dhe të gjithë ata që nuk kishin një, kishin nga dy, ndërsa personalitetet më të spikatura kishin shumë dhe madje groteske. Për shembull, kreu i kishës ishte Barkmadh, Djersitës, Vidanombytës, nga vidan-pëllumb, etj. Vetëm ata, duke bërë përjashtim, ndanin të njëjtën nofkë - nga gjysmë, le të themi. Dhe kishin të drejtë bashkëqytetarët e tyre, sepse edhe atyre të uruarve u kishte marrë koka erë me gjithë ato fasule që hanin.

Hanin çdo drekë te Likato. Jo vetëm ngaqë ishin të lira, por edhe sepse u pëlqenin. Për Petron të paktën, nuk bëhej fare fjalë për familjarizim, për atë që në të kaluarën përbënte ushqimin kombëtar. Kur ishte i vogël në fshat, sado e çuditshme që të dukej, i hante para dreke. Sigurisht që i gatuanin për darkë, por gjithmonë qëllonte që t’i hanin në mëngjes, pas një kalitjeje respektive nervash. Një procedurë që lulëzoi gjatë viteve ’50-’60. Rrinin të gjithë rreth e rreth sofatit, një minder prej guri poshtë pjergullës,

dhe prisnin që të zienin. Kur nëna jepte sinjalin, ai ia merrte vrapit që të ngrinte të atin nga loja me letra, fuste marshin e katërt, si thoshte, trrrr... dhe fillonte të këndonte me zë të lartë, sepse, edhe afër varrezave kalonte, por edhe mund të ndeshte ndonjë patrullë angleze. Të bërtitura, nerva, ankesa se nuk ishin të ziera mirë, dhe sigurisht që nuk ishin, e si mund të ishin? Ato lloj fasulesh nuk arrijnë të ziejnë në dy orë, dhe madje në zjarr me dru. Të bërtitura, kërcënime se do të valonte druri, që jo gjithmonë mbeteshin në kuadrin e kërcënimeve. Binin për të fjetur pa ngrënë. Por i kollofisnin si të babëzitur në agim, kur çdo kërcënim ishte larguar gjatë çlodhjes së natës dhe gjumit.

Vetëm se Likatoja, kuzhinieri, tregohej dorështrenguar me vajin, vajin e virgjër si quhej. Në fillim, para se të kishin arsye për t'u turpëruar, protestuan disa herë, por më kot.

- Çfarë kërkon? Të notojnë në vaj?

I vështronte madje dhe me përbuzje. Kushdo që vë përparësen e kuzhinierit, ka përshtypjen e gabuar se mund të vështrojë me përbuzje të gjithë klientët që nuk porosisin gjellë me mish.

Vetëm se ky kuzhinieri ynë e bënte këtë ngaqë e konsideronte veten si pjesëtar të familjeve të mira të qytetit të vogël, si pjesëtar të “aristokracisë”. Dhe kjo ngaqë kishte një djalë mjek edhe... Edhe? I mjeri ti, që t'i përkasësh asaj kategorie që kujton se i përket, duhet që të djersijë nëpër kuzhina, jo vetëm prapanica jote, por edhe prapanica e dhjetë të tjerëve, në mos e tridhjetë apo dhe njëqind të tjerëve, ndërsa prapanica jote, nëse do që ta dish, të mos djersijë. Por më tepër ishte e bija që i jepte një përshtypje të tillë, dhe ai e huazonte fshehurazi. Ajo ishte mbi njëzet e pesë vjeçe, as e bukur, por as e shëmtuar, ngiste një makinë të vjetër *Moris Oksford* dhe shoqërohej me vajza

të aristokratëve. Në vendet ku ato mblidheshin që të binin në sy të njerëzve, ajo shoqërohej zakonisht me të bijat e Rosidhit, milionerit të Afrikës. Është e vërtetë, zoti Likato, se për Rosidhin derdhën djersë me mijëra zezakë. Rrinte dhe me të bijat e Kseros, mjekut patolog të diplomuar në Angli.

Megjithëse e kishte lëkurën me puçrra, e bija e Likatos binte në sy ndoshta prej ecjes së saj kërcimthi si kalë - megjithëse nuk e demonstronte shpesh, sepse më tepër lëvizte me makinë - si dhe mosbegenisja e saj për të të parë në sy. Sa herë rastiste që ata të dy të porosinin fasule te Likato, kalonte edhe ajo andej. Bënte një apo dy hapa të mëdhenj, i pëshpëriste diçka të atit dhe në ikje u hidhte një vështrim të ashpër fasuleve, por asnjëherë dy nëpunësve. Kjo gjë i detyroi të manovronin. E ndërronin porosinë, herë duke marrë bishtaja, të së njëjtës familje, ndërsa një herë në javë merrnin mish të pjekur. Andrea përpiquej t'i shmangej mishit të pjekur, sepse në fundjavë dhe të mërkurave ai hante në shtëpi - në Lapitho. Një variant tjetër ishte të hanin fasule në një lokal tjetër, një ditë po e një ditë jo, por këtu i zienin si e ëma e Petros, gjë që krijonte probleme të tjera. Kështu që porosia e fasuleve te Likato rrallohej, sidomos në prani të vajzës së tij. Ndihehin më mirë, porosinin dhe ndonjë qepë të vockël, sa koka e një foshnje.

Erdhi momenti dhe sipas ligjeve të natyrës, Petroja filloi të ndiente dhimbje barku, për shkak të sasisë së madhe të metanit që zorrët e tij ishin të detyruara të përpunonin dhe që një moment këtë sasi metani e nxori në mënyrë të pakontrolluar dhe të shoqëruar me zhurmë, pikërisht atëherë kur automjeti *Moris Oksford* mbërriti në restorant.

Thashethemet morën dhenë, dhe sado që për momentin u duk sikur ajo nuk ishte e interesuar ta zgjaste këtë temë

- u përhap lajmi se një e pjerdhur e fortë e kapi shkarazi të bijën e Likatos dhe puçrrat në faqet e saj u zmadhuan pikërisht për këtë shkak. Përfundimisht kjo ndodhi rezultoi në disfavor të saj.

Pikërisht në këtë kohë edhe një ndodhi tjetër ndihmoi që të ndërpriteshin marifetet e palavdishme Likato - nëpunës. Gjyshe Elisavet, ndonjëherë i thërriste edhe kështu për të treguar konsideratën e tij për plakën, nuk i duronte dot thashethemet keqdashëse për “të pjerdhurën prej mushke”, ose pordhë mushke apo gjysmëgomari, si do të përkthehej në gjuhën popullore. A, kështu! E pra, atë “kështu” do ta shohim pas pak.

### *Dashuri dhe japrakë*

Një natë, kur u kthye i stërlodhur nga një turne që kishte bërë matanë malit Pentadhaktillo, i mbuluar me pluhur dhe i mbytur në djersë, vajti menjëherë në banjë për të bërë një dush. Plaka, që bënte gjumë si lepur mbi një kanape, u ngrit ashtu në errësirë për ta pritur, dhe i tha se e bënte me dëshirë, meqenëse kishte që në mëngjes pa e parë. Plaka e donte Petron. Kishte edhe ajo një djalë, mjek në profesion, por që vinte rrallë për ta parë, si çdo djalë që ka arritur njëfarë niveli më të lartë dhe ka turp për prindërit e vet, ose ngaqë nuk ka se çfarë të bisedojë me ta. Për më tepër, u martua me një infermiere, dhe e kupton vetë ti, plaka nuk e përtypi kurrë këtë.

Kishte Petron në vend të të birit. Nga të gjithë qiraxhinjtë, vetëm ai i bënte ndonjëherë shoqëri. E pinin kafenë së bashku, ajo me sakarinë, ngaqë ishte diabetike. Në pranverë, Petroja i sillte lule nga shpatet e lulëzuara të Shën Epiktitit. E mësoi



se si të durojnë gjatë pa u vyshkur, duke ua prerë kërcejtë herë pas here dhe duke tretur aspirinë në ujë. E donte edhe për faktin se, si thoshte vetë, ishte “më i dituri”, në krahasim me të tjerët, kishte dhe çarçafë prej mëndafshi. Dallonte nga qiraxhinjtë e tjerë, që nuk lexonin as edhe një rresht, ndërsa ai vetëm libra sillte në dhomë. Petroja ia rriste rëndësinë edhe bujtinës së saj. Po pse, bujtina e Perikliut pak më poshtë, mos vallë ishte më e mirë? Megjithatë, ai qiraxhiu, me profesion dentist kirurg, ia rriste vlerën e bujtinës së tij, pavarësisht faktit se kush i binte në dorë dilte prej tij me infeksion dhe me rrezikun që të humbiste nofullën.

Mbaroi dushin dhe vajti në dhomë për t’u veshur. Ishte i zhveshur nga mesi e lart kur trokiti dera. Para se të mendohej se çfarë do të bënte, nga dera gjysmë e hapur u duk një kokë gruaje, që me një buzëqeshje disi dinake përzier me budallallëk, i tha se zonja Alisava e ftonte për të ngrënë. - Me siguri që do të jesh i uritur, - i tha, - dhe i lodhur. Vërtet, je i lodhur? - pyeti më pas nga ana e saj. Një buzëqeshje tjetër dinake, por më simpatike. Ajo grua mund të ishte rreth të tridhjetave.

Po e priste te dera që të dilnin bashkë dhe gjoja gabimisht ajo u ndal pak, për faj të saj, dhe gjoksi i tij u mbështet mbi supin e saj lakuriq. Gabim që zgjoi urinë e një lloji tjetër, urinë e paepur. - Ha-ha, nuk ka gjë, - shqiptoi ajo tërë naze. - E kush tha se ka, - u përgjigj menjëherë Petroja, dhe pastaj u dëgjua një e qeshur e fortë... Mirë thonë, se nëse lodhja sjell të qeshura, këto janë të papërmbajtura. Por, për të mirë a për të keq, u fut ai i pari, se ndonjëherë nuk i dihet nga futet shejtani. Nëse kjo do të ishte ndonjë e afërt e gjyshes, atëherë do të ishte punë e ngatërruar, janë gjëra të rrezikshme këto. Kemi dhe një motër të pamartuar, mendoi Petroja dhe priu para, ndërsa ajo e ndoqi pas dhe zbritën shkallët.

- Mban aromë të këndshme, - ia plasi sërish ajo, duke nuhatur, apo ndoshta duke iu dridhur flegrat nga aroma e fortë e sapunit *lux* që lëshonte trupi i tij.

Gjyshja i priste në kuzhinë. Në fakt nuk po rrinte duke pritur. Njëren dorë të përkulur, s'e lëvizte, ndërsa me tjetrën, dhe me ndihmën e një luge prej druri, po përpiquej që të servirte japrakë në një pjatë.

Vajza nuk ia shqiste sytë Petros. Plaka u inatos, jo për atë që do të mendonte çdokush, ashtu siç rezultoi pak më vonë, por, sepse vajza po linte mënjanë punën e saj, domethënë që t'i shtronte menjëherë tavolinën Petros.

Ai kishte vite pa vënë në gojë japrakë kaq pa shije. Poshtë mbulesës së tavolinës, ndjeu diçka të ngrohtë që po i fërkohej pas këmbë. Ngacmimi ia ndryshon përbërjen pështymës, shijen ushqimit. Më vonë ai mësoi se kjo quhet mungesë shijeje prej ndjenjave erotike.

- Ti nuk po ha asgjë, - tha gjyshja. - Janë shumë të shijshëm. Sa për këtë, Ana është e zonja në gatim. E pata punësuar edhe më parë dhe mbeta shumë e kënaqur. Rëndësi ka që të qëndrojnë kësaj here.

Gjyshja dha informacione të çmuara. Pra, nuk është e afërmja e saj, nuk ka ndonjë djallëzi në këtë mes.

- Do të qëndroj, zonja Alisava, do të qëndroj, - thoshte ajo dhe vazhdimisht ia shkelte syrin Petros në mënyrë provokuese.

Në një moment, kur Ana vajti të sillte kokakolë, gjyshja e afroi edhe më karrigen te Petroja dhe i tha me zë të ulët.

- A është mirë, mor bir, t'ju quajë bota "fasulexhinj"... dhe çdo krijesë e pashije të thotë lart e poshtë se pordhët? Pse nuk jep dhe pesë lira të tjera që të hash bashkë me ne? - përfundoi plaka.

Pesë lira ishte një shumë simbolike. Me po të njëjtën dëshirë, para pesëmbëdhjetë ditëve, plaka i dha dhomën më të mirë, me pamje nga deti dhe me ballkon, ku mund të jetonte vetëm. Madje mori nga dhoma të tjera një kanape të modës së vjetër dhe një tavolinë të gdhendur që mbështetej në mur, për të cilat qiraxhinjtë që i kishin nuk interesoheshin fare. Rregulloi me pak fjalë një dhomë të pranueshme, në mos të denjë për një nëpunës shteti, si këmbëngulte që ta quante gjyshja sa herë që i jepej rasti.

- Ana, shko shtroi krevatin, - tha gjyshja kur mbaruan kokakolën. - Do të jesh i lodhur, - vazhdoi ajo, duke iu drejtuar Petros.

Kur ai u ngjiti në dhomë, gjeti Anën të shtrirë në kanape. Me t'u hapur dera, ajo u ul ndenjtur dhe u rehatua në njërën anë të kanapesë, thua se ajo ishte e zonja e kësaj dhome.

- Dëshiron një konjak? - i propozoi ajo duke i treguar shishen mbi tavolinë.

- Është i ngrohtë, - i përgjigj ai, ndërkohë që pështyma, me atë mungesë shijeje në gojë, e paralajmëronte për të pashmangshmen.

- Po shkoj të sjell akull. Të shoh edhe nëse e ka zënë gjumi plakën, - i tha Ana tërë naze, duke mbyllur me nënkuptim njërin sy.

Duke kërkuar ndonjë muzikë të përshtatshme në radion e dorës, mendoi se, një drej e di, por mund edhe të kërcenin aty brenda. “Dhe kur nuk di të vallëzosh, lëre fare”, i kujtua fraza që përdorte mësuesi i fizkulturës në gjimnaz. “Janë gjëra djallëzore këto, të tundë në këtë mënyrë tjetri trupin e vet”, i pati thënë një herë i ati duke e vështuar nga një e çarë, teksa ai lëvizte nën ritmin e muzikës që transmetonte radioja. Që atëherë, gjithëka i shkoi mbrapsht. Në gjimnaz, mësuesi i ri i fizkulturës, që ishte në konflikt

të vazhdueshëm me Triplon, mblidhte nxënësit në dhomë dhe u mësonte vallëzimet e reja. Po ai? Ai nuk mundi të mësonte vallen dyshe, apo vallen tradicionale qipriote me valltarët përballë njëri-tjetrit, si do të mësonte... valle të nivelit evropian, si valsi dhe të tjera? Mbeti edhe, nuk vajti asnjëherë në mësimet e vallëzimit që jepte mësuesi i fizkulturës. Vetëm ndonjëherë, tek ecte në korridor, ndalej për pak dhe dëgjonte fshehtazi ritmin, që për të që i panjohur. Nuk pati nevojë për vallëzim.

Kur Ana solli akullin, ai u ngrit për të hedhur konjak në gota.

- Lëre, i mbush unë, - tha ajo, dhe teksa brofën në këmbë të dy njëherësh, trupat e tyre u ngërthyen në pasqyrën e tavolinës. U vështuan për një moment në sy, pastaj gjithçka u shemb në kanape. Gota, trupa, copa akulli. U ngjitën me njëri-tjetrin për një moment, pastaj u përleshën për pak si një amalgamë që kërciste, por për shumë pak kohë. U qetësuan, të paktën trupi i tij u qetësua. Muskujt e tij u çtendosën, pre e muskujve të tendosur të Anës, të cilët ishin ende të elektrizuar. Kërkonin me dëshpërim rrymën e induksionit, e cila ishte ndërprerë në mënyrë të palavdishme.

Për herë të parë trupi i tij ishte i shtrirë krah një trupi tjetër, pa qenë nevoja që fillimisht të vinte dorën në xhep për të vendosur ekuivalentin e shërbimit të ofruar mbi komodinë, aty në krah të abazhurit, që e kishte kokën prej qelqi gjithë stërkala nga të ndoturat e mizave.

Deri atëherë përvoja e tij erotike kufizohej në shtëpitë publike të Sucos, afër ujërave termale të Emerkes, ku nxënësit hynin tufa-tufa, duke shfrytëzuar rastin sa herë që shkonin në Nikozi. Por ai kurrë nuk mbante të holla me vete, shumicën e rasteve shkonte sa për shoqëri. Ndonjëherë

merrte hua ndonjë dhjetëshe dhe e shlyente në këtë mënyrë detyrimin ndaj trupit të vet.

Në kthim dëgjonte eksperiencat pa mbarim nga tregtia e trupit, veçanërisht nga Patrokli, që i kishin vënë nofkën “Erotillo” dhe që fryhej si gjeldeti, ngaqë ia kishte dalë, siç thoshte, ta bënte dy herë “marsh” siç e quanin zakonisht. Pastaj u shtuan dhe të tjerë në listën e atyre që kishin mbaruar punë dy herë. Duke dëgjuar këto, ai ia vinte fajin “pandezshmërisë” së tij, sepse për të qenë të saktë, kurrë nuk ia kishte dalë për të bërë “marsh” vetëm me një prenotim. Vetëm një herë në Lemeso, në rrugicat përreth “Sheshit të Heronjve”, kur i kishin tepruar ca të holla nga ato që i kishte dhënë teza e vet. Doli, bëri një xhiro dhe u fut përsëri për të shkuar me një vajzë tjetër.

- E mirë de, nëse është kështu, shkon dhe gjyshi im, - krekosej me të madhe Patrokli, duke bërë me duar shenja kuptimplotë.

Patrokli, “Erotillo” siç i thoshin, jo vetëm ia dilte, por kishte dhe një mënyrë komode të përshkruari (megjithëse në hartim ishte nxënës i dobët), saqë të vinte në dilemë - nëse duhej t’i kundërviheshe apo t’i aprovoje arritjet e tij. Normale dhe të mbinatyrshme. I plotësonte përshkrimet dhe me kafshë e shpendë, e kështu marifetet e tij të diskutueshme erotike u shndërruan në legjendë. Shokët e klasës flisnin edhe për objekte jofrymore, si për shembull kana e ujit me bletë të egra brenda që i ënjtën kokën e penisit. Në fillim vrenjtej kur dëgjonte këto insinuata thumbuese, por pastaj i aprovonte dhe i shumëfishonte në një masë të tillë, saqë çdokush duhej t’i kalonte nëpër sita para se t’i pranonte. Pastrueset e shkollës, shumica e tyre të paktën, kishin rënë viktimë e këtyre tregimeve - pjellë e fantazisë së tij. Veçanërisht Ekavi, e cila punonte në kuzhinë, rreth njëzet

e dy vjeçe dhe shumë e bukur. Në emër të bukurisë së saj, kishin ndodhur me mijëra prishje të pavullnetshme në gjumë, ndërsa me miliona spermatozoide patën një fund të palavdishëm teksa i mori me vete uji i lavamanit.

Kjo e fundit e kishte zanafillën edhe nga lakmia e Triplos për t'u ndaluar të rinjve gjëra të ndryshme si dhe shqetësime që i tërhiqnin vëmendjen dhe që kishin lidhje me synetllëkun e nxënësve, që pak a shumë i dukej si një e keqe e pashmangshme e adoleshencës.

Zelli pastoral i teologut me këmbënguljen e tij tekanjoze për t'i dalë para rrezikut të shthurjes morale, pati si rezultat që duset e reja që u ndërtuan në shkollë, të mos ishin më të përbashkëta, por personale. Që të mos shihnin trupin e njëri-tjetrit, dhe në këtë mënyrë të zhvilloheshin tendenca homoseksualiteti - në këtë moshë ziliqare për Triplon. Një teori tejet e gabuar, sepse nxënësit familjarizoheshin me pamjen që kishte trupi i huaj mashkullor, zbutej çdolloj misticizmi në lidhje me burrërinë e organit mashkullor dhe nuk shkaktonte asgjë të ngjashme me dyshimet e poshtra të teologut. Të vetmen gjë që mund të shkaktonte ishte antagonizmi ziliqar në lidhje me madhësinë e penisit, sepse secili prej tyre, duke vështruar organin e tij dhe vetëm nga lart - prerje nga lart le të themi - e konsideronte atë më të vogël se të tjerëve. Por ishte një iluzion që u kapërcye shpejt. I vetmi që nuk ishte iluzion optik, dhe për të cilin binin të gjithë heshtazi dakord, ishte organi i Gavrias, dukshëm më i madh se i tjerëve. Dhe përbënte çudi sesi kishte mbërritur në veshët e Triplos kjo informatë. Sigurisht, duke qenë një njeri që vinte veshin për të dëgjuar fshehtazi, mund të dinte madje edhe madhësinë e saktë me centimetra.

Ajo që pa dyshim arriti teologu, ishte që të vihej re një rritje, memece, por e dukshme, e rasteve të masturbimit,